Shoqeria " ATELIER 4 " sh.p.k.

Raporti i Audituesit Ligjor
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR	3-4
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	9 – 23

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

Ortakëve dhe Drejtimit të shoqërisë "ATELIER 4" sh.p.k.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregëtare "ATELIER 4" sh.p.k. të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.
Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqërisë tregëtare "ATELIER 4" sh.p.k. më 31 dhjetor 2019, performancen financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.* Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.
Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësia e Audituesit

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.
Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, auditori :

- Identifikon dhe vlerëson rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, planifikon dhe kryen procedurat përkatëse të auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, si dhe merr evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin e tij.

- Siguron njohje të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme sipas rrethanave , por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.

-Vlerëson përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe te cmuarjeve kontabël të kryera , si dhe të shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.

-Shprehet në lidhje me parimin e vijimësisë bazuar në evidencat e siguruara gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston dhe që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrihet në përfundimin që një pasiguri materiale ekziston, audituesi është i detyruar të shprehet në raportin e auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës , ose nëse shënimet shpjeguese janë të papërshtatshme , të modifikojë opinionin e tij për pasqyrat financiare.

Gjatë auditimit auditori komunikon me personat përgjegjës të ngarkuar për drejtimin e Shoqërisë, dhe i bën të ditur Drejtimit përvecse cështjeve të tjera edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet kryesore të auditimit.Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit

29 KORRIK 2020

Tiranë, Shqipëri

AUDITUESI LIGJOR

Brunilda STEFA

AUDITUES LIGJOR
STUDIO TREFIN
Brunilda Stefa
Nr.Lic.192
K81608034Q
KONTABEL I MIRATUAR

ATELIER 4 sh.p.k.
Bilanci për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Shumat janë të shprehura në LEK)

Aktivet	Viti 2019	Viti 2018
Aktive Afatshkurtra		
Likujditete dhe vlera te tjera arke	24,734,660.61	92,982,063.11
Kerkesa per arketim nga debitoret	120,156,538.17	86,258,356.84
Te tjera kerkesa	4,054,605.00	6,898,006.84
Kerkesa nga njesite ku ka interesa	13,454,664.15	3,878,699.36
gjendje inventari dhe ne proces	0.00	0.00
shpenzime te paguara ose te regj. Avance	15,988,755.60	18,291,765.09
Totali i Aktiveve Afatshkurtra	**178,389,223.53**	**208,308,891.24**
Aktivet Afatgjata		
Aktive te qendrueshme te patrupezuara	56,000.00	56,000.00
Aktive te qendrueshme te trupezuara	64,839,489.29	68,694,123.07
Aktive te qendrueshme financiare		
Totali Aktiveve Afatgjata	64,895,489.29	68,750,123.07
Totali i Aktiveve	**243,284,712.82**	**277,059,014.31**
Pasivet		
Detyrimet Afatshkurtra		
Hua afatshkurter	(600,016.00)	35,903,546.00
Shuma te arketuara per porosi	601,335.00	601,335.00
Furnitore per sherbime	93,380,604.71	61,032,446.73
Personeli	1,116,835.00	800,738.00
Detyrime te tjerate tjera	19,762.00	213,736.89
Shteti Tatim Taksa	3,777,246.57	7,905,998.40
Provizione	5,536,117.70	5,536,117.70
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra	**103,831,884.98**	**111,993,918.71**
Detyrimet Afatgjata		
Hua afatgjate	9,036,510.30	12,209,551.83
Provizione afatgjata		
Totali I Detyrimeve afatgjata	**9,036,510.30**	**12,209,551.83**
Kapitalet e veta		
Kapitali I nenshkruar	55,100,000.00	90,700,000.00
Rezerva ligjore	10,000.00	10,000.00
Rezerva statutore	0.00	0.00
Rezerva te tjera	57,731,413.60	49,936.00
Fitime/Humbje te mbartura		48,537,247.79
Fitime dhe Humbje te ushtrimit	17,574,904.47	13,558,358.19
Totali i Kapitaleve te veta	**130,416,318.07**	**152,855,541.98**
Totali i Pasiveve	**243,284,713.35**	**277,059,012.52**

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ATELIER 4 sh.p.k.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë të shprehura në LEK)

Te ardhurat	Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi +/-
Nga Veprimtaria			
nga kryerje e sherbimeve	239,618,034.56	248,350,320.25	(8,732,285.69)
te tjera	69,959.66	395,579.17	(325,619.51)
Totali Ardhurave nga veprimtaria	239,687,994.22	248,745,899.42	(9,057,905.20)
Te ardhura te tjera			
Shtesa e gjendjeve te prodhimit te vet	0.00	0.00	0.00
Shitja e aktiveve te qendrueshme	822,066.67	0.00	822,066.67
Totali i Ardhurave te tjera	822,066.67	0.00	822,066.67
Totali i Ardhurave	**240,510,060.89**	**248,745,899.42**	**(8,235,838.53)**
Shpenzime te veprimtarise			
Materiale te para+mallra	0.00	0.00	0.00
Personeli	56,776,003.60	40,246,771.00	16,529,232.60
Tatime dhe taksa	0.00	0.00	0.00
Humbje nga mosarketimi I debitoreve			0.00
Shpenzime Transporti	0.00	0.00	0.00
Te tjera	163,109,626.00	180,503,469.10	(17,393,843.10)
Amortizimi I llogaritur	7,487,762.29	7,456,949.55	30,812.74
Totali i Shpenzimeve	**227,373,391.89**	**228,207,189.65**	**(833,797.76)**
Fitimi nga veprimtaria e shfrytezimit	**13,136,669.00**	**20,538,709.77**	**(7,402,040.77)**
Te Ardhurat nga njesite ku ka interesa	9,575,964.79	3,878,699.36	
Te ardhura dhe shpenzime nga interesat	(484,865.71)	(550,309.82)	65,444.11
Fitime -humbje nga kembimi	(1,598,607.38)	(6,985,241.04)	5,386,633.66
Te ardhura dhe shp. te tjera financiare	0.00	0.00	0.00
Totali I te Ardhurave dheShpenzimeve financiare	**7,492,491.70**	**(3,656,851.50)**	**11,149,343.20**
financiare			
Fitimi Bruto	20,629,160.70	16,881,858.28	3,747,302.42
Shpenzime te pazbritshme	6,116,524.00	5,274,809.00	
Humbje e mbartur			
Tatimi mbi Fitimin 15 %	2,575,457.99	3,323,500.09	-748,042.10
Tatimi mbi Fitimin e pjesmarrjeve	478,798.24		
Fitimi Netto	**17,574,904.47**	**13,558,358.19**	4,016,546.29

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ATELIER 4 sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Kapitali i nenshk.	Rezervat	Provizionet	Fitimi I Akumuluar	Kapitalet e Veta
Bilanci me 31 Dhjetor 2017	90,700,000	59,936		48,537,246	139,297,182
Emetimi I aksioneve					-
Pozicion I rregulluar					-
Fitimi vitit 2018				13,558,358	13,558,358
Dividentet e paguar					-
Rritja e rezerves se kapitalit				-	
Bilanci 31 Dhjetor 2018	90,700,000	59,936	-	62,095,604	152,855,540
Emetimi I aksioneve	(35,600,000)			35,600,000	-
Pozicion I rregulluar					-
Fitimi Vitit 2019				17,574,904	17,574,904
Dividentet e paguar				(40,014,125)	(40,014,125)
Rritja e rezerves se kapitalit		57,681,478		(57,681,478)	-
Bilanci 31 Dhjetor 2019	55,100,000	57,741,414	-	17,574,906	**130,416,320**

Shenimet mbi pasqyrat financiare ne faqet vijuese jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare

Keto pasqyra financiare jane aprovuar nga drejtimi I " ATELIER 4 " -Dege e Shoqerise se Huaj dhe jane firmosur nga

ADMINISTRATORI
Alban EFTHIMI

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ATELIER 4 sh.p.k.

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Viti 2019	Viti 2018
Aktivitetet Operative		
Fitim / Humbja e vitit	20,629,160.70	16,881,858.28
Amortizimi dhe zhvleresimi (dif konvert)	7,487,762.29	7,456,949.55
(Rritja)/ Ulja e inventareve	0.00	0.00
(Rritja) / Ulja e kerkesave te arketueshme	(33,898,181.33)	(26,379,672.36)
(Rritja) / Ulja e kerkesave te tjera	(4,429,553.46)	2,575,434.00
Rritja (Ulja) e detyrimeve	(8,162,033.73)	275,658.00
Rritja / (Ulja) e detyrimeve te tjera afatgjata	(3,173,041.53)	0.00
Tatim fitimi I paguar	(3,054,256.23)	(3,323,500.00)
Cash flow nga veprimtaria e shfrytezimit	**(24,600,143.28)**	**(2,513,272.53)**
Aktivitetet e Investimeve		
Blerje e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	(4,455,195.18)	(5,714,161.00)
Shitje e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	822,066.67	0.00
Korrigjim I Fondit te Amortizimit	0.00	0.00
Fluksi I parase nga Investimet	**(3,633,128.51)**	**(5,714,161.00)**
Aktivitetet financiare		
Rritja e kapitalit ne para	0.00	0.00
Te Ardhura nga huamarrje afatgjata	0.00	(2,672,386.00)
Pagesat e detyrimeve te qerase financiare	0.00	0.00
Pagesa e dividenteve	(40,014,128.38)	0.00
Rivleresim I fitimit te mbartur sipas aktkontrollit		
Fluksi I parase nga aktiviteti financiar	**(40,014,128.38)**	**(2,672,386.00)**
CASH FLOW (Ulja)	**(68,247,400.17)**	**(10,899,819.53)**
Cash dhe Banka ne fillim te periudhes	**92,982,063.11**	**105,994,059.00**
Cash dhe Banka ne fund te periudhes	**24,734,660.61**	**92,982,063.11**

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ADMINISTRATORI
Alban Efthimi

HARTUESI I PASQYRAVE FINANCIARE
Kazazi Consulting

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria "ATELIER 4" sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 01 Shkurt 2003 dhe e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 01 Maj 2003.
Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.
Sipas ekstraktit te QKB Përfaqësues ligjor i shoqërisë është Z. Alban Efthimi.
Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 ishte 90,700,100 LEK. Gjatë vitit 2019, kapitali aksionar ka patur ndryshime, është bërë zvogëlimi i kapitalit në shumën 35,600,000 LEK një pjesë e të cilës ka shkuar për rritjen e rezervave të tjera dhe një pjesë për shpërndarje dividenti ortakëve të shoqërisë. Kapitali fillestar me 31 Dhjetor 2019 eshte ne shumen 55,100,000 LEK.
Kapitali i Shoqërisë është kapital i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
Struktura e kapitalit aksionar më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është detajuar në shënimin 12 të pasqyrave financiare

Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është projektime dhe studime urbanistike, projektime dhe ndërtime civile,industriale turistike, bujqësore;studime ambjentale dhe vlerësim i ndikimit në mjedis, studime dhe projektime hidrogjeologjike dhe gjeologjike,projektime rrugësh, urash, porte turistike, projektime të inxhinierise elektrike, hidromekanike, supervizion punimesh si dhe konsulenca për temat e mësipërme.

Shoqëria është regjistruar si tatimpagues në Njësinë e Tatimpaguesve të Degës së Tiranës me numër indentifikimi (NIPT) K31812012H. Adresa e saj e regjistruar është Njesia administrative 5, Rruga "Kosovareve", Ndertesa 35, Hyrja 6, apartamenti4/1, Tiranë.
Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 55 (pesëdhjetepesë) punonjës.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatim Fitimi", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos regjistrojë tatim të shtyrë në pasqyrat e veta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në Lek Shqiptar "LEK".

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me USD dhe Euro më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	**31 dhjetor 2018**
US Dollar (USD)	108.64	107.82
Euro (EUR)	121.77	123.42

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtare të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset monetare të aktivit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 4.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mblëdhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe vonesat në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kur pjesë të një aktivi afatgjatë materal kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) dhe janë pasqyruar neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të aktive afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.
Aktivet e marra me qira amortizohen me metodën lineare duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet. Të gjitha aktivet e tjera amortizohen me metodën e vlerës së mbetur.

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur e pronave, pajsjeve dhe makinerive janë rishikuar në datën e raportimit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZDHIM)

3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi (vazhdim)

Metodat e amortizimit dhe norma e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

Kategoria e aktivit	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Ndertime	Mbi vlerën kontabël neto	5%

3.4 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një ose më tepër ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe që kanë patur një ndikim në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit.

Në veçanti aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivet jo financiare

Vlera kontabël (neto) e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus kostos së shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të pritshme skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivit për të cilat parashikimet e flukseve të ardhshme monetare nuk janë rregulluar.
Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria nuk ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkojë flukse dalëse monetare për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZDHIM)

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me arkëtimin e pagesës dhe matjen e kostove përkatëse.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shoqëria ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave;
- Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në manaxhimin e mallrave në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë; si dhe nuk ka kontroll efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të merren nga njësia ekonomike; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë rrjedhëse në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë interesat nga huamarrjet dhe humbjet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka). Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

4. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2019 janë si vijon:

	31/12/2019	*31/12/2018*	*Ndryshimi +/-*
Para ne dore	474,366.00	9,179,664.00	(8,705,298.00)
Para ne Banka	24,260,295.00	83,802,400.00	(59,542,105.00)
Totali	**24,734,661.00**	**92,982,064.00**	**(68,247,403.00)**

Mjetet monetare në bankë përfshijnë llogaritë rrjedhëse në lekë dhe valutë me të cilat Shoqëria kryen pagesat si dhe arkëton kërkesat nga të tretët. Shoqëria përvec mjeteve monetare në llogaritë rrjedhëse ka dhe një garanci bankare afatshkurtër në BKT në shumën 2,499,999 LEK e cila është paraqitur në zërin aktive financiare të tjera.

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE TË TJERA

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera më 31 dhjetor 2019 përbëhen si vijon:

	31/12/2019	*31/12/2018*	*Ndryshimi +/-*
Klientet	120,156,538.17	86,258,356.84	33,898,181.33
Tatim Fitimi	360,286.00		360,286.00
Kerkesa te tjera ku ka interesa	13,454,664.15	3,878,699.36	9,575,964.79
Te tjera	3,694,319.00	6,898,006.84	(3,203,687.84)
Shpenzime te parapaguara	15,988,755.60	18,291,765.09	(2,303,009.50)
Totali	**153,654,562.91**	**115,326,828.13**	**40,630,744.28**

Klientët pasqyrojne vlerën e akumuluar të situacioneve (faturave) që evidentojnë vlerën e shitjeve që shoqëria ka kryer dhe që nuk janë arkëtuar brenda vitit ushtrimor 2019.
Në këtë zë rezulton edhe shuma 13,454,664 LEK e cila përfaqëson kërkesa nga njësitë ekonomike ku ka interesa , përkatesisht fitimet e realizuara dhe të patransferuara nga dega e shoqërisë në Kosovë. Kërkesa të tjera rezultojnë në shumën 4,054,608 LEK e cila përfaqëson tatim fitimi të paguar me tëpër paradhenie në shumën 360,286 LEK, garancia bankare në shumën 2,449,999 LEK si është shpjeguar në shënimin nr.4 të pasqyrave financiare, parapagime të dhëna në shumën 384,010 LEK si dhe shuma 860,310 LEK tatime të shtyra.

6. INVENTARI

Shoqëria nuk ka gjëndje të inventarit pasi ajo ushtron aktivitetin e saj në fushën e shërbimeve dhe të konsulencave për të tretët.

7. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Shoqëria ka kryer *Parapagime dhe shpenzime të shtyra* gjatë ushtrimeve të mëparshme, të cilat më 31 dhjetor 2019 janë në shumën 15,988,756 LEK dhe që përfaqesojnë shpenzime që i përkasin disa periudhave ushtrimore. Shoqëria përdor një kuotë për shpërndarjen e këtyre shpenzimeve në shpenzime të periudhës ushtrimore .Për vitin 2019 shuma e këtyre shpenzimeve e cila ka rënduar rezultatin është 2,303,010 LEK.

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh të qëndrueshme 64,839,490 LEK. Nga kontrollet me zgjedhje të përdorura rezultoi se në aktiv të bilancit paraqiten të gjitha aktivet për të cilën shoqëria ka titull pronësie, se ato paraqiten të vlerësuara me vlerën e tyre të hyrjes në shoqëri, se ato ekzistojnë realisht, klasifikimi i tyre në elementë të veçantë është bërë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligji "Për Kontabilitetin". Për të gjitha ndryshimet në Aktive të Qëndrueshme ekziston dokumentacioni përkatës.

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhen si vijon:

	Gjendja e Aktiveve te Qendrueshme ne date 31.12.2019							
	Ndertesa	Mjete transporti	Makineri Pajisje	Paisje zyre	Pajisje informatike	Instrumenta dhe vegla	Te tjera	Totali
Aktive te Trupezuara								
Gjendje 31.12.2018	65,617,666.62	13,478,264.47	2,735,000.00	5,448,716.80	8,716,209.94	2,190,641.83	4,831,045.67	103,017,545.33
Shtesa 2019	0.00	2,771,759.00	0.00	35,262.50	1,458,718.34		270,556.67	4,536,296.51
Pakesime 2019		(2,073,600.00)	0.00	0.00	0.00		0.00	(2,073,600.00)
Gjendje 31.12.2019	**65,617,666.62**	**14,176,423.47**	**2,735,000.00**	**5,483,979.30**	**10,174,928.28**	**2,190,641.83**	**5,101,602.34**	**105,480,241.84**
Amortizimi								
Gjendje ne 31.12.2018	18,553,960.22	2,178,124.07	2,475,307.82	3,109,698.33	5,103,935.07	1,725,982.02	1,176,414.73	34,323,422.26
Shtesa llogaritur	2,353,185.32	2,061,049.33	51,938.00	688,822.49	1,135,524.12	274,918.93	922,323.86	7,487,762.05
Korrigjim fondi		(1,170,432.00)	0.00	0.00	0.00			(1,170,432.00)
Gjendje ne 31.12.2019	**20,907,145.54**	**3,068,741.40**	**2,527,245.82**	**3,798,520.82**	**6,239,459.19**	**2,000,900.95**	**2,098,738.59**	**40,640,752.31**
Vlera neto 31.12.2018	47,063,706.40	11,300,140.40	259,692.18	2,339,018.47	3,612,274.87	464,659.81	3,654,630.94	68,694,123.07
Vlera neto 31.12.2019	**67,970,851.94**	**11,107,682.07**	**207,754.18**	**1,685,458.48**	**3,935,469.09**	**1,536,241.14**	**(1,555,892.35)**	**64,839,489.53**

Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara është llogaritur sipas normave të nenit 22 të ligjit 8438 date 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të ardhurat"
Llogaritja e amortizimit është bërë për shumën 7,487,762 LEK, kontabilizuar edhe në shpenzime.
Sipas llogaritjeve për efektin fiskal shoqëria ka përdorur normat ligjore të amortizimit

9. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Shoqeria ka Aktive Afatgjata Jomateriale ne shumen 56,000 LEK .

10. TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

Të pagueshme tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2019 përbëhen si vijon:

	31/12/2019	*31/12/2018*	*Ndryshimi +/-*
Furnitoret	93,380,604.71	61,032,446.73	32,348,157.99
Arketime per porosi	601,335.00	601,335.00	0.00
Hua te tjera(ortake)	(600,016.00)	35,903,546.00	(36,503,562.00)
Detyrime te tjera	19,762.00	213,736.89	(193,974.89)
Shteti tatim taksa	4,894,081.57	8,706,736.40	(3,812,654.83)
Totali	**98,295,767.28**	**106,457,801.01**	**(8,162,033.73)**

Të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 në shumën 93,380,605 LEK përfaqësojnë detyrimet e shoqërisë për furnizimet e kryera gjatë ushtrimit . Pas verifikimeve të bëra rezulton se shumat e mësipërme përputhen me tepricat e llogarive përkatëse analitike të furnitorëve në fund të periudhës ushtrimore 2019.
Detyrimet në shumën - 600,016 LEK përfaqësojnë detyrimet e ortakëve ndaj ndaj shoqërisë per shuma të tërhequra gjate vitit.

Parapagimi i arkëtuar në shumën 601,335 LEK konsiston në përqindje të vlerës totale të kontratës të parapaguar nga ana e klientëve dhe që do të zbritet me përfundimin e shërbimit.

Detyrime të tjera në shumën 19,762 LEK përfaqëson detyrime për shpenzime të llogaritura në shumën 19,028 LEK dhe detyrime të tjera në shumën 734 LEK.

Të pagueshme ndaj shtetit në shumën 4,894,082 LEK përfaqësojnë detyrimet e shoqërisë për tatime e taksa të muajit Dhjetor 2019 dhe përkatësisht përmbajnë detyrimet për sigurimet shoqërore në shumën 1,116,835 LEK, tatimi mbi të ardhurat personale në shumën 681,577 LEK , tatimi në burim në shumën 2,295,210 LEK si dhe TVSH për t'u paguar në shumën 800,459 LEK sipas tabelës së mëposhtme:

	31/12/2019	*31/12/2018*	*Ndryshimi +/-*
Tatim fitimi	0.00	0.00	
Shteti TVSH-Kreditore	800,459.00	5,284,039.00	(4,483,580.00)
Sigurime Shoqerore	1,116,835.00	800,738.00	316,097.00
TAP	681,577.00	411,812.00	269,765.00
Tatim ne burim	2,295,210.00	2,210,148.00	85,062.00
Totali	**4,894,081.00**	**8,706,737.00**	**(3,812,656.00)**

Të gjitha keto shuma përputhen me formularet e deklarimit të tyre .

11. PROVIGJIONE AFATSHKURTRA DHE HUA AFATGJATA

Shoqëria ka krijuar provigjione në shumën 5,536,118 LEK si zhvlerësim për shuma të paarkëtuara nga klientë të periudhave të hershme dhe të cilat nuk ka arritur ti arketojë.
Gjithashtu shoqëria ka dy kredi afatgjata një në Bankën Raiffeisen sipas kontratës së Leasingut datë 20 Prill 2018 në shumën 33,591 EUR dhe një në Banken Popullore në shumën 40,618.72 EUR , të cilat të përkthyera me kursin e Bankës së Shqipërisë të datës 31 dhjetor 2019 janë përkatesisht në shumat 4,090,369 LEK dhe 4,946,142 LEK sipas tabelës së mëposhtme:

	31/12/2019	*31/12/2018*	*Ndryshimi +/-*
Provizione	5,536,117.70	5,536,117.70	0.00
Hua afatgjatë	9,036,510.30	12,209,551.83	(3,173,041.53)
			0.00
Totali	**14,572,628.00**	**17,745,669.53**	**(3,173,041.53)**

12. KAPITALI FILLESTAR

Më 31 dhjetor 2019, kapitali fillestar ka vlerën 55,100,000 LEK dhe përbëhet nga 4 pjesë me vlerë nominale përkatësisht sipas përqindjeve 1 pjesë 33,060,000 LEK, një pjesë 11,020,000 LEK, një pjesë 5,510,000 LEK dhe një pjesë 5,510,000 LEK. Bazuar në ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare, 5% e fitimit vjetor, duhet të kalojë çdo vit në rezervë ligjore, deri sa rezerva të arrijë vlerën 10% të kapitalit aksionar. Gjatë periudhes ushtrimore 2019 ka patur ndryshime në kapitalin fillestar . Me vendimin për shpërndarjen e fitimit të vitit 2018 është bërë edhe ulja e kapitalit fillestar në shumën 35,600,000 LEK , është bërë rritja e rezervave të tjera në shumën 57,681,478 LEK dhe është bërë shpërndarje dividenti ortakëve në shumën 40,014,125 LEK.
Struktura e ortakeve dhe kapitalit është si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019		**Më 31 dhjetor 2018**	
	Në %	**Në vlerë**	**Në %**	**Në vlerë**
Alban EFTHIMI	60%	33,060,000	60%	54,420,000
Altin PREMTI	20%	11,020,000	20%	18,140,000
Andi EFTHIMI	10%	5,510,000	10%	9,070,000
Olsi EFTHIMI	10%	5,510,000	10%	9,070,000
TOTALI	**100%**	**55,100,000**	**100%**	**90,700,000**

13. TË ARDHURA NGA SHITJA

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**
Shitja e neto	239,618,035	248,350,320
Shitja e aktiveve	822,067	0.00
Te ardhura te tjera	69,959.66	395,579.17
TOTALI	**240,510,061**	**248,745,899**

14. KOSTO E PRODUKTEVE TË SHITURA

Shoqëria nu ka shpenzime për kosto të produkteve të shitura .

15. KOSTOT E PERSONELIT

Kostot e personelit përbëhen nga pagat dhe shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore si më poshtë vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Pagat e personelit	-49,872,954	-35,131,794
Sigurime shoqërore e shëndetësore	-6,903,050	-5,114,977
TOTALI	**-56,776,004**	**-40,246,771**

16. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzime të tjera me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime qiraje	-728,982	-479,420
Shpenzime energji elektrike	-3,313,274	-1,991,312
Shpenzime kancelari	-1,371,156	-835,814
Shpenzime per komisione bankare	-243,954	-149,524
Shpenzime nga te trete	-132,403,849	-128,293,170
Shpenzime mirembajtje	-1,840,784	-1,437,744
Shpenzime donacione	-2,310,751	-600,000
Kosto aktivit te shitur	-903,168	-26,565,990
Shpenzime transporti	-2,837,919	-1,225,025
Taksa të tjera	-463,851	-345,920
Shpenzime publicitet reklama	-140,865	-153,749
Shpenzime te tjera	-10,094,196	-11,359,033
Shpenzime te panjohura	-423	-4,448,988
Shpenzime pritje percjellje	-6,456,454	-2,617,782
TOTALI	**-163,109,626**	**-180,503,470**

17. FITIMI / (HUMBJA) NGA KURSET E KËMBIMIT NETO

Fitimet / (humbjet) nga kurset e këmbimit janë si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitime të realizuara nga kurset e këmbimit	651,154	1,585,542
Humbje të realizuara nga kurset e këmbimit	-2,249,765	-8,570,786
TOTALI	**-1,598,611**	**-6,985,244**

18. TË TJERA FITIME / (HUMBJE) FINANCIARE, NETO

Të tjera fitime / (humbje) financiare janë si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesi	4	
Shpenzime interesi	-484,866	-550,307
TOTALI	**-484,862**	**-550,307**

19. TATIM FITIMI

Shoqëria është subjekt i tatim fitimit në Shqipëri, norma e tatim fitimit për vitin 2019 është 15%. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.Meqënëse shoqëria ka një degë të saj në Kosovë ku ajo është 100% pjesmarrëse,fitimin neto të degës në Kosovë pas pagesës së tatimit në masën 10% e ka përfshire në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe për këtë ka kredituar pjesën e tatimit të huaj në bazë të Ligjit për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Llogaritja e normës së tatim fitimit efektiv për vitin 2019 dhe 2018 është paraqitur në vijim:

	2019	%	2018	%
Fitimi para tatimit	20,629,161	100%	16,881,858	100%
Tatim fitimi me normën e aplikuar	2,136,778	15%	2,532,279	15%
Shpenzimet e pa zbritshme	917,479	15%	791,221	15%
Humbje e mbartur	0		0	
Tatim fitimi	**3,054,256**		**3,323,500**	
Parapagime gjatë vitit	0		6,738,042	
Tatim fitimi i pagueshëm	**-360,286**		**-3,414,542**	

Parapagimet gjatë vitit 2019 nuk ka patur pasi shoqëria ka patur mbipagesë të tatim fitimit në periudhat paraardhese në shumën 3,414,542 LEK .

20. ANGAZHIME DHE DETYRIME TE KUSHTËZUARA

Çështje gjyqësore

Më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, Shoqëria nuk është përfshirë në procedura ligjore, pretendime dhe çështje gjyqësore me palët e treta. Drejtimi beson se çdo ngjarje e ardhshme e mundshme nuk do të ketë një ndikim material negativ mbi pozicionin financiar, rezultatin e operacioneve apo rrjedhën e parasë së Shoqërisë.

21. PALËT E LIDHURA

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një influencë të ndjeshme mbi palën tjetër, ose kur kanë kontroll të përbashkët të një njësie tjetër ose kur është anëtar i personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është pushteti për të drejtuar politikat financiare dhe operacionale të një shoqërie në mënyrë që të marrësh përfitime nga aktiviteti i saj. Kontrolli ekziston kur mëma, direkt ose indirekt, zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votave, të shoqërisë bijë.
Në vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019, transaksionet me palë të lidhura i korrespondojnë shumave të huamarrjeve me kompaninë mëmë dhe letrës së garancisë së lëshuar nga kjo kompani në emër të shoqërisë shqiptare.
Shoqëria ka plotësuar dhe dorëzuar në autoritetet tatimore shqipëtare brenda afateve ligjore, dokumentacionin e lidhur me transferimin e çmimit për këto transaksione.

22. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(a) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të ndeshet me vështirësi në ngritjen e fondeve për të përmbushur angazhimet e lidhura me instrumentat financiare. Shoqëria monitoron likuiditetet e veta periodikisht në mënyre që të manaxhojë detyrimet e veta kur ato duhen paguar.

Aktivet financiare që sjellin interes kanë të bëjnë me llogari rrjedhëse dhe depozita afatshkurtra në banka.

Tabela e likuiditeteve më poshtë është hartuar në bazë të maturimeve kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare.

31 dhjetor 2019	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1 deri 5 vjet	Maturim i pacaktuar	Totali
Llogaritë e arkëtueshme	13,094,378	360,286.00	124,211,143	-	-	137,665,807
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	24,734,661	-	-	-	-	24,734,661
Shpenzime te periudhave te ardhme	-	-	15,988,756		-	15,988,756
Totali i aktiveve	**37,829,039**	**360,286**	**140,199,899**	**0**	**0**	**178,389,224**
Llogaritë e pagueshme	1,116,835	19,762.00	93,981,940	(600,016.00)	-	94,518,521
Tatim fitimi i pagueshëm	-	0	-	-	-	0
Detyrime të tjera	3,777,247		-		9,036,510.30	12,813,757
Provigjione afatshkurtra	-	-		5,536,117.70		5,536,118
Totali i detyrimeve	**4,894,082**	**19,762**	**93,981,940**	**4,936,102**	**9,036,510**	**112,868,395**
Ekspozimi neto	**32,934,957**	**340,524**	**46,217,959**	**-4,936,102**	**-9,036,510**	**65,520,828**

22. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2018	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1 deri 5 vjet	Maturim i pacaktuar	Totali
Llogaritë e arkëtueshme	3,878,699		93,156,364		-	97,035,063
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	92,982,063	-	-	-	-	92,982,063
Shpenzime te periudhave te ardhme	-	-	18,291,765		-	18,291,765
Totali i aktiveve	**96,860,762**	**0**	**111,448,129**	**0**	**0**	**208,308,891**
Llogaritë e pagueshme	800,738	213,736.89	61,633,782	35,903,546.0 0	-	98,551,803
Tatim fitimi i pagueshëm	-		-	-	-	0
Detyrime të tjera	7,905,998		-		12,209,551.8 3	20,115,550
Provigjione afatshkurtra	-	-	-	5,536,117.70		5,536,118
Totali i detyrimeve	**8,706,736**	**213,737**	**61,633,782**	**41,439,664**	**12,209,552**	**124,203,471**
Ekspozimi neto	**88,154,026**	**-213,737**	**49,814,347**	**-41,439,664**	**-12,209,552**	**84,105,421**

22. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(b) Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i këmbimit valutor është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet nga ndryshimet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja.

Ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor

Ekspozimi neto i Shoqërisë ndaj rrezikut të këmbimit valutor në 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

31 dhjetor 2019	EUR (ekuivalenti ne LEK)	USD (ekuivalenti ne LEK)	LEK	Totali
Llogaritë e arkëtueshme	21,674,420		115,991,387	**137,665,807**
Shpenzime te periudhave te ardhme	-	-	15,988,756	**15,988,756**
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	13,830,499		10,904,162	**24,734,661**
Totali i aktiveve	**35,504,919**	**0**	**142,884,305**	**178,389,224**
Llogaritë e pagueshme	8,385,069		86,133,452	**94,518,521**
Tatim fitimi i pagueshëm	-	-	0	**0**
Detyrime të tjera	9,036,510	-	3,777,247	**12,813,757**
Provigjione afatshkurtra	-		5,536,118	**5,536,118**
Totali i detyrimeve	**17,421,579**	**0**	**95,446,816**	**112,868,395**
Ekspozimi neto	**18,083,340**	**0**	**47,437,488**	**65,520,828**

Ekspozimi neto i Shoqërisë ndaj rrezikut të këmbimit valutor në 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

31 dhjetor 2018	EUR (ekuivalenti ne LEK)	USD (ekuivalenti ne LEK)	LEK	Totali
Llogaritë e arkëtueshme	83,056,336		13,978,727	**97,035,063**
Shpenzime te periudhave te ardhme	-	-	18,291,765	**18,291,765**
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	43,943,591		49,038,472	**92,982,063**
Totali i aktiveve	**126,999,927**	**0**	**81,308,964**	**208,308,891**
Llogaritë e pagueshme	9,706,139		88,845,664	**98,551,803**
Tatim fitimi i pagueshëm	-	-		**0**
Detyrime të tjera afatshkurtra	12,209,552	-	7,905,998	**20,115,550**
Provigjione afatshkurtra	-		5,536,118	**5,536,118**
Totali i detyrimeve	**21,915,691**	**0**	**102,287,780**	**124,203,471**
Ekspozimi neto	**105,084,236**	**0**	**-20,978,815**	**84,105,421**

23. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme të cilat kërkojnë rishikime ose ndryshime në këto pasqyra financiare. Në fund të vitit 2019 dolën për herë të parë lajmet nga Kina në lidhje me COVID-19 (Coronavirus). Situata në fund të vitit ishte se një numër i kufizuar i rasteve të një virusi të panjohur ishin raportuar në Organizatën Botërore të Shëndetit. Në muajt e parë të vitit 2020 virusi ishte përhapur globalisht dhe ndikimi i tij negativ ka fituar një impuls. Manaxhimi e konsideron që informacion të jetë një ngjarje jo rregulluese pas datës së raportimit. Ndërsa kjo është ende një situatë në zhvillim në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, deri më tani nuk ka pasur ndonjë ndikim të dukshëm në operimet e Kompanisë, megjithatë efektet e ardhshme nuk mund të parashikohen. Manaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm për të zbutur çdo efekt.

Tirane me, 29 KORRIK 2020

AUDITUESI LIGJOR

BRUNILDA STEFA

AUDITUES LIGJOR
STUDIO TREFIN
Brunilda Stefa
Nr.Lic 182
K81608034Q
KONTABEL I MIRATUAR